

# Bashkia Has



## DISCLAIMER

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të Instrumentit të Planifikimit Financiar 2021 – 2023 dhe të dhënat e paraqitura në relacionin shoqërues të programit buxhetor afat – mesëm. Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Has me asistencën e Projektit Bashki të Forta.



# Përmbajtja

<b>Fjalor shpjegues.....</b>	<b>3</b>
<b>Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë .....</b>	<b>4</b>
<b>Vështrim mbi Buxhetin Afatmesëm 2021 - 2023 .....</b>	<b>5</b>
<b>Burimet e Financimit .....</b>	<b>6</b>
<b>Shpenzimet buxhetore .....</b>	<b>7</b>
<b>Administrimi i bashkisë .....</b>	<b>8</b>
<b>Kujdesi social për familjet dhe fëmijët .....</b>	<b>10</b>
<b>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor .....</b>	<b>11</b>
<b>Rrjeti rrugor rural .....</b>	<b>14</b>
<b>Shërbimet publike vendore .....</b>	<b>16</b>
<b>Furnizimi me ujë .....</b>	<b>18</b>
<b>Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile .....</b>	<b>20</b>

## Fjalor shpjegues

### **Taksat e ndara**

Janë taksa kombëtare të mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

### **Tasat vendore**

Janë detyrime fiskale të bashkisë e cila paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

### **Tarifat vendore**

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

### **Transfertat e kushtëzuara**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për tu përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

### **Transfertat e pakushtëzuara**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti shtetit) i jep bashkisë për tu përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

### **Transfertat specifike**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për tu përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

### **Trashëgimi nga viti kaluar**

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

## Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë

### Bashkia Has



Bashkia Has e pozicionuar në verilindje të vendit përbëhet nga 4 Njësi Administrative (Golaj, Krumë, Gjinaj, Fajzë,) me sipërfaqe prej 399.62 km<sup>2</sup>. Sipas Censurit të vitit 2011, Hasi ka 16.790 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 21.247 banorë. Ka një densitet prej 42.01 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit 2011.

Hasi kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Krumës, i cili u shpall qytet në vitin 1994.

**EKZEKUTIVI** Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Bashkinë Has për zgjedhjet vendore të vitit 2019 ishte 15,811 persona. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e fundit lokale ishte 27,53%. Këshilli bashkiak përbëhet nga 21 anëtarë të grupuar midis partive politike PS, PASH, PMDE, PDS.

Kryetari i Bashkisë është **Z. Liman Morina**

Zyrat kryesore të administratës së Bashkisë përfshijnë: financë dhe buxhet, tatim taksa vendore, politikat e zhvillimit, shërbimet publike, bujqësia dhe pyjet, shërbimet sociale, planifikim dhe kontrolli i teritorrit, policia bashkiake, mbrojtja e teritorrit, ligjore, administrata dhe burimet njerëzore, arsim dhe edukim.

**EKONOMIA** Hasi është një zonë që mbijeton falë të ardhurave që vijnë nga emigrimi dhe bujqësia, megjithëse disponon burime të konsiderueshme minerare.

Në zhvillimin e ardhshëm të teritorrit janë përcaktuar 3 drejtime kryesore të zhvillimit.

- ✿ Zhvillimi industrisë minerare
- ✿ Mbështetja në sektorin bujqësisë
- ✿ Promovimi i turizmit të natyrës

*Bashkia ka mbyllur një vit të vështirë pandemik në 2020 që sjell sfida të rëndësishme në zhvillimin e saj lidhur me:*

- ✿ Mbështetjen e shtresave në nevojë
- ✿ Zhvillimin ekonomik kryesisht të bujqësisë dhe industrisë nxjerrëse minerare
- ✿ Mbështetjen e biznesit për të kapërcyer situatën e vështirë COVID '19.

## Vështrim mbi Buxhetin Afatmesëm 2021 - 2023

Bashkia ka përgatitur një buxhet realist dhe të ekuilibruar. Bashkia synon të shlyeje gradualisht detyrimet e prapambetura nga vitet e kaluara duke përmirësuar marrëdhëniet kontraktuale të bashkisë kundrejt biznesit.

Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, mbrojtja nga zjarri, arsimi mesëm, menaxhimi infrastrukturës së vaditjes dhe kullimit, trashëgimia kulturore, shërbimet e policisë vendore dhe menaxhimi i pyjeve dhe kullotat janë prioritetet e buxhetit të vitit 2021 duke qënë të vetmet shërbime për të cilat buxheti i vitit 2021 vjen në rritje kundrejt vitit 2020. Kujdesi social për familjet dhe fëmijët, furnizimi me ujë të pijshëm, shërbimet publike, arsimi bazë dhe parashkollor, dhe mbrojtja nga zjarri zënë peshën më të madhe në financimin e buxhetit të bashkisë për tre vitet e ardhshme. Këto 5 shërbime zënë rreth 80% të buxhetit të bashkisë.

Bashkia do të përmirësojë shërbimet e ofruara për komunitetin me anë të një fondi investimesh në vlerën totale rreth 111 milionë lekë ose rreth 8% më shumë krahasuar me vitin 2020 i cili do të financojë shërbime të tilla si: ndërtimi ujësjellësit rajonal për njësinë administrative Golaj, përmirësim i rrugëve në zonat rurale dhe rrugë të brendshme në qytet, vendosja e kazanëve të mbetjeve urbane etj.

Bashkia synon përmirësimin e efijencës financiare – me të njëjtat fonde ofrohen më shumë shërbime për komunitetin.

## Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (000 Lekë)	NDRYSHIMI	2018	2019	2020	PLAN 2021	PLAN 2022	PLAN 2023
	10.5%	661,288	582,332	534,484	590,368	493,742	581,309
Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2018	Fakt 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
	Huamarrje						
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga taksat e ndara	5,665	4,027	5,250	5,250	5,250	5,250
	Të ardhura nga taksat lokale	2,797	1,515	3,483	3,596	3,658	3,722
	Të ardhura nga tarifa vendore	7,265	4,602	8,065	8,226	8,438	8,657
	Të ardhurat e tjera	2,935	4,640	5,031	7,558	2,825	3,188
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e kushtëzuar	413,105	75,577	76,191	340,940	252,164	328,166
	Transferta e pakushtëzuar	115,662	137,117	141,374	144,202	145,216	156,135
	Transferta specifike	62,957	319,054	289,565	80,596	76,191	76,191
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi me destinacion	10,609	18,733	4,210			
	Trashëgimi pa destinacion	40,293	17,067	1,315			




Figura 1. Peshë e burimit të financimit në totalin e të ardhurave


Bashkia financohet në raportin rreth 4% me 95% nga të ardhurat e veta dhe transfertat e qeverisë qendrore. Ky raport planifikohet të përmirësohet në peshën që kontribuojnë burimet e veta të bashkisë në 3 vitet e ardhshme.

Të ardhurat e veta janë rritur me 48% në fund të vitit 2020 krahasuar me vitin 2019, ky tregues pozitiv reflekton punën e bërë nga bashkia në sigurimin e të ardhurave nga burimet e veta edhe pse një vit shumë i vështirë për gjithë biznesin në përgjithësi

Në tërësi për vitin 2021 bashkia planifikon:

- ✿ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë do të rriten me 10% krahasuar me vitin 2020;
- ✿ Të ardhurat nga burimet e veta do të rriten me 13%.

# Shpenzimet buxhetore



## Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 planifikojnë rritje të fondeve. Peshën më të madhe të buxhetit e zënë këto shërbime të bashkisë për të cilat jepet shkurtimisht performanca e tyre:

- ✿ *Kujdesi social për familjet dhe fëmijët*
- ✿ *Furnizimi me ujë*
- ✿ *Shërbimet publike vendore*
- ✿ *Arsimi bazë përfshirë parashkollorin*
- ✿ *Administrata e bashkisë*
- ✿ *Mbrojtja nga zjarri*
- ✿ *Rrjeti rrugor*

## Administrimi i bashkisë

VITI 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
	34,983	7.23%	-20.75%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korente dhe investime

### Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin



Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
➔	Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	27.60	0.00	0.00	0.00	0.00

Produkte	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Numri total i personave të trajnuar	15	20	35	50	0

Të dhëna	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	69	0	0	0	0
Numri total i punonjësve të bashkisë	250.0	254.0	254.0	254.0	254.0

### Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia planifikon shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Performanca e administratës së bashkisë do të përmirësohet duke:

- ✿ Rritur kapacitetet profesionale të administratës – më shumë punonjës të trajnuar
- ✿ Rritur qëndrueshmërinë e administratës – më pak lëvizje të personelit nga puna

INVESTIMET E BASHKISË	2019	2020	2021	2022	2023
Adminstrimi i bashkisë	138,056	103,237	111,442	48,194	121,394
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	2019 Fakt	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Blerje paisje zyre dhe kompjuterike & Zyre	851	0	300	0	0
Rikonstruksion i Pallatit 4kt, rruga Dardania	5,000	10,000	6,584	0	0
Studime Projektme	1,377	1,000	0	0	0
Supervizim Objektesh	231	0	400	0	0

## Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

VITI 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
	259,033	47.47%	-10.57%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 2: Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për familjet dhe fëmijët: korrente dhe investime

### Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për mbështetjen e familjeve dhe fëmijëve në nevojë.

#### Trendi

##### Objektivat dhe Treguesit e Performancës



Numri i çerdheve dhe kopshteve funksionale (Ndryshimi vjetor në numër)

Fakti 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
0.00	0	0	0	0

Produkte	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Fëmijë të shërbyer në kopshte	184	0	0	0	0
Kopshte funksionale	1	0	0	0	0

## Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për ofrimin e shërbimit të kujdesit për famijet dhe fëmijët në nevojë sipas përcaktimeve ligjore si edhe për fëmijët e çerdheve. Shërbimi do të do të përmirësohet duke realizuar:

- ✱ Mbështetur më shumë familje dhe fëmijë në nevojë dhe shtresa të marxhinalizuar
- ✱ Vënien në funksionim të kopshtit për ti shërbyer fëmijëve në moshën 3-6 vjec

## Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
<b>VITI 2021</b>	<b>35,974</b>	<b>6.63%</b>	<b>-11.02%</b>

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 3: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi bazë përfshirë parashkollorin: korrente dhe investime

## Qëllimi i programit buxhetor

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
↑	Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)	99.68	100	98	99	99
→	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë në %)	11.92	12	12	12	12
→	Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë në %)	15.95	16	16	16	16
↑	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Lekë/institucion)	3,294,951.32	822,854	213,636	404,545	375,000

Produkte	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë	22	22	22	22	22

Të dhëna	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç	565	565	550	540	540
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	174	173	173	172	172
Mësues në sistemin parashkollor	30	30	25	25	25
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç	567	567	559	546	546
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	218	218	215	210	210
Numri klasave në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	130	130	130	130	130

Numri klasave në sistemin parashkollor	126	126	120	120	120
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	2,074	2,065	2,060	2,055	2,055

### Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave. Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet janë realizuar përgjatë vitit 2019 ndërkohë që gjatë vitit 2021 do të shfrytëzohen ambientet e përmirësuar për të rritur cilësinë e shërbimit në shkollat 9 vjeçare të bashkisë.

Shërbimi do të përmirësohet duke realizuar:

- ✿ Rritjen e punës për ruajtjen e frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë;
- ✿ Ruajtjen e normës mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues edhe pse numri i nxënësve që frekuentojnë këtë sistem arsimor është rritur nëpërmjet rritjes së numrit të mësuesve.
- ✿ Uljen e kostos së një institucioni arsimor duke përmirësuar eficiencën e përdorimit të parasë publike për këtë shërbim

Shpenzimet për këtë funksion parashikohen me ulje pasi përgjatë viteve të kaluara janë realizuar investime të rëndësishme në këto institucione.

INVESTIMET E BASHKISË	2019	2020	2021	2022	2023
<b>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</b>	138,056	103,237	111,442	48,194	121,394
<b>Në mijë Lekë</b>					
Emërtimi i Projektit	2019 Fakt	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Hapje Pusi uji dhe instalime hidraulike Shkolla 9-Vjeçare Nikoliq	416	0	0	0	0
Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare Tregtan	20,132	0	0	0	0
Rindërtim Shkolla 9-vjeçare Letaj	44,033	17	0	0	0
Supervizim Ndërtim Shkolla 9-Vjeçare Letaj	180	300	0	0	0
Supervizim Punimesh rindërtim Shkolla 9-Vjeçare Letaj	180	0	0	0	0

## Rrjeti rrugor rural

VITI 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
	16,675	2.84%	-3.86%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Rrjeti rrugor rural: korente dhe investime

### Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i komunikimit ndërllokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
→	Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në %)	0.00	0	0	0	0
→	Rrugë rurale (rrjeti rural ndryshimi vjetor në %)	0.00	0	0	0	0
↑	Rrugë rurale dhe urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në %)	36.41	7	2	7	0

↑	Rrugë rurale të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në %)	36.41	7	2	7	0
→	Rrugë urbane (rrjeti urban ndryshimi vjetor në %)	0.00	0	0	0	0
↑	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Lekë për 1 km rrugë rurale	95,417.63	95,070	96,230	102,030	102,030
↑	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Lekë për 1 km rrugë rurale + urbane	80,116.49	71,936	72,719	83,907	94,406
↑	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Lekë për 1 km rrugë urbane	36,151.22	5,467	5,167	31,833	72,500

Produkte	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Km rrugë të mirëmbajtura në vit	112	120	122	130	130
Km rrugë të shtruara (asfaltuara + shtruara me cakull) në vit	0	0	0	0	0
Rrugë rurale të mirëmbajtura	112	120	122	130	130
Rrugë urbane të mirëmbajtura	0	0	0	0	0

Të dhëna	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Rrjeti rrugor në km (Total rrugë rurale + urbane / inventari rrugëve)	232	232	232	232	232
Rrjeti rrugor rural	172	172	172	172	172
Rrjeti rrugor urban	60	60	60	60	60
Shpenzime buxhetore për menaxhimin e rrjetit rrugor në Lekë:	18,619,073	16,718,000	16,900,000	19,500,000	21,940,000
Shpenzime për menaxhimin e rrjetin rural	16,450,000	16,390,000	16,590,000	17,590,000	17,590,000
Shpenzime për menaxhimin e rrjetin urban	2,169,073	328,000	310,000	1,910,000	4,350,000

### Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor të saj qoftë në pjesën urbane apo rurale të saj. Shërbimi do të përmirësohet duke mirëmbajtur rreth 53% të gjithë rrjetit të saj rrugor.

INVESTIMET E BASHKISË	2019	2020	2021	2022	2023
<b>Rrjeti rrugor rural</b>	138,056	103,237	111,442	48,194	121,394
<b>Në mijë Lekë</b>					

Emërtimi i Projektit	2019 Fakt	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Ndërtim Rruge Malore Qendër Fshati Gjinaj - Stanet, Bjeshka Gjinaj & Rikonstruksion I Rrugës Segmenti Gjinaj - Pus I Thatë	0	4,000	2,000	3,400	0
Rehabilitim i Rrugës Fshatit Zahrisht	18,010	0	28	0	0
Rehabilitim i rrugëve Pazari vjetër dhe lagje peka dhe did (Kontratë në vazhdim)	20,128	10,441	5,227	0	0
Rikonstruksion rruga e Fshatit Ukperaj (Perollaj)	8,000	10,000	4,126	0	0
Supervizim Rehabilitim asfaltim rruga Zahrisht	0	28	0	0	0
Supervizim Rikonstruksion rruga e Fshatit Ukperaj (Perollaj)	0	82	0	0	0

## Shërbimet publike vendore

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
<b>VITI 2021</b>	50,934	9.58%	-12.89%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 6: Kategoritë e shpenzimeve për programin Shërbimet publike vendore: korrente dhe investime



## Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i shërbimeve publike vendore për gjithë komunitetin e saj qoftë në qytet apo njësitë administrative

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
→	Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %)"	41.67	41.7	41.7	41.7	42.0
→	Lekë të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifat vendore (në %)	3.00	2.0	2.0	2.0	2.0
↓	Rrënjë pemë dekorative (fondi I pemëve në hapësirat e gjelbërta (Ndryshimi vjetor në %)	17.00	14.0	0.0	0.0	0.0
↓	Total km linear trotuar (Ndryshimi vjetor në %)	100.00	0.0	0.0	0.0	0.0

Produkte	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Rrënjë pemë të mbjella në vit	40	40	40	50	50

Të dhëna	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Fondi total i pemëve dekorative / gjelbëruese të bashkisë	70	80	80	80	80
Sipërfaqe totale e e gjelbër publike në Km2	1	1	1	1	1
Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit	160,000	175,000	184,000	193,000	203,000
Të ardhurat nga tarifat vendore	4,602,000	8,065,000	8,226,000	8,438,000	8,657,000
Trotuare në km linear	2	2	2	2	2

### Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për gjelbërimin e hapësirave publike, shtimin dhe përmirësimin e trotuareve, mirëmbajtjen e varrezave publike. Për shkak të shkurtimit të fondeve për shërbimet publike bashkia synon të realizojë të njëjtin nivel shërbimesh sikurse vitin e kaluar.

## Furnizimi me ujë

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
<b>VITI 2021</b>	90,497	10.86%	36.61%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Furnizimi me ujë: korente dhe investime

### Qëllimi i programit buxhetor

Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda në qytet dhe gjithë njësitë administrative të bashkisë.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
→	Orë ujë në ditë (Ndryshimi vjetor në orë)	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
→	Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm kundrejt popullsisë totale të bashkisë (në %)	62.00	62.00	62.00	62.00	62.00
→	Të ardhura kundrejt shpenzimeve totale (plus investime dhe amortizimi) (në %)	9.00	9.00	9.00	9.00	9.00

Produkte	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm	8	8	8	8	8
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm (banorë)	13,448	13,448	13,448	13,448	13,448

Të dhëna	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Kosto totale për shërbimin e ujit të pijshëm (+ investime dhe amortizimi)	135,000,000	135,000,000	135,000,000	135,000,000	135,000,000
Popullsia totale e bashkisë	21,750	21,750	21,750	21,750	21,750
Të ardhurat nga tarifa e ujit të pijshëm	12,000,000	12,000,000	12,000,000	12,000,000	12,000,000

### Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për ofrimin e shërbimit me ujë të pijshëm dhe gjithë administrimin e problemeve të furnizimit me ujë, duke siguruar pastërtinë e ujit, çmimin e përballueshëm dhe sasinë e nevojshme për familjet dhe bizneset në të gjithë bashkinë. Përgjatë viteve të kaluara ashtu edhe në vitetet në vijim do të vazhdojnë investimet për ngritjen dhe vënien në funksionim të kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë. Performanca e administratës së bashkisë do të përmirësohet duke realizuar:

- ✿ Më shumë personave u ofrohet ujë i pijshëm
- ✿ Më shumë territor mbulohet me furnizimin e ujit të pijshëm
- ✿ Rritja e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të pijshëm për banorët
- ✿ Mbulimi i koston së prodhimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm nga tarifat e shërbimit.

Duke qenë se ky është një shërbim në zgjerim mbështetur me investime të rëndësishme bashkia do të mbledhë dhe raportojë të dhëna që tregojnë performancën e shërbimit kur sistemi i zgjeruar i ujit të pijshëm ti vihet në shfrytëzim.


INVESTIMET E BASHKISË	2019	2020	2021	2022	2023
<b>Furnizimi me ujë</b>	138,056	103,237	111,442	48,194	121,394
<b>Në mijë Lekë</b>					

Emërtimi i Projektit	2019 Fakt	I pritshmi 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Blerje kontenierë 1100 l	0	0	960	0	0
Kolaudim Punimesh	0	0	300	0	0
Kolaudim Punimesh Ujësjiellësi Rajonal	0	0	0	0	598
Rikonstrukcion ujësjiellësi fshatit Zahrisht	9,400	163	0	0	0
Supervizim Ndërtim Ujësjiellësi Rajonal për njësinë administrative Golaj, Për fshatrat Dobrone, Qarr I Vogël, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has	0	797	797	630	1,760

## Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

VITI 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi me 2020 në %
	26,258	3.28%	31.10%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



### Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia garanton shërbimin zjarrfikës, parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.

Produkte	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Raste të menaxhuara nga MZSH	20	18	18	17	17

Të dhëna	Fakti 2019	2020 i pritshmi	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Numri i stacioneve të MZSH që ka bashkia	1	1	1	1	1
Koha e daljes nga stacioni në sekonda (mesatare ditën plus natën)	60	60	60	60	60

### Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia planifikon shpenzime për funksionimin e njësisë zjarrfikëse dhe të shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Në këtë shërbim bashkia ofron edhe mbrojtjen civile. Shërbimi do të përmirësohet duke:

- ✿ Konsoliduar njësinë zjarrfikëse e cila u krijua për herë të parë në vitin 2016;
- ✿ Rritur kapacitetet profesionale të punonjësve zjarrfikës;
- ✿ Rritur numrin e rasteve të parandalimit të zjarreve
- ✿ Ulur kohën e reagimit ndaj njoftimeve për raste zjarri apo mbrojtje civile
- ✿ Ardhur në ndihmë banorëve në nevojë gjatë këtij viti pandemik.